

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	Drejtorati për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 06-121/019	Data: Datum: 16.09.2019	

Në mbështetje të nenit 8 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr 03/L-212 e miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, nenit 4 i Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik shpallë:

K O N K U R S

Titulli i vendit të punës: Gjellëbërës
 Numri i referencës: 121/2019
 Numri i Ekzekutuesve 1 (një)
 Niveli i Pagës: Koefficienti 5.5
 Kohëzgjatja e Emërimit: Në kohë të pa caktuar
 Orët e Punës: 40 Orë
 Puna Provuese : 6 muaj.

Punët dhe detyrat:

- Përgatitja e ushqimeve: ushqime te ftohta,paragjella,supa,gjella,roshtil,sallata dhe ëmbëlsira.
- Kontrollon rregullsinë e artikujve ushqimor të cilat i merr në përgatitje.
- Kujdeset për shpenzim të artikujve ushqimor sipas normativit.
- Është përgjegjës për kualitetin e ushqimeve dhe sallatave.
- Bën përpunimin e artikujve ushqimor me urdhrin e shefit të shërbimit.
- Në mungesë të shefit të shërbimit bën organizimin e shpërndarjes së ushqimeve me kohë për rezident
- Kujdeset për përdorimin e mjeteve të kuzhinës në mënyrë të rregullt:
- Është përgjegjës për materialin dhe artikujt ushqimor ne të cilat ngarkohet nga shefi i shërbimit;

Shkathtësit e kërkuara (kualifikimet, përvojat si dhe shkathtësit e tjera qe kërkohen për këtë vend të punës):

- Shkolla e mesme e kryer drejtimi i hotilerisë apo kuzhinier;
- Përvoja e punës të pakten 3 vite në kuzhinë;
- Gatishmëri e plotë për ofrim të shërbimeve rezidentëve;
- Gatishmëri për komunikim dhe trajtim të gjithë rezidentëve pa dallim etniteti;
- Shkathtësi për komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Aftësi për përmbushjen e detyrave dhe punëve nën presion.
- Njohja e punës me kompjuter e dëshirueshme ;

Dokumentët e kërkuara:

Diploma e Shkolles se Mesme, drejtimi hotelieri, kuzhinier;
 Çertifikatën e Lindjes;
 Dëshmi për përvojën e punës;

Dokumenti i Identifikimit;
Çertifikata që nuk jeni nën hetime.

Të drejtë për punësim kanë të gjithë personat e moshës madhore të cilët kanë zotësi për të vepruar, janë në posedim të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë e duhur për kryerjen e detyrave të punës.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informimit.

Kandidatët e interesuar mund ti marrin aplikacionet çdo ditë pune, në Qendrën për Shërbim me Qytetar – Istog –kati i parë zyra nr:100, dhe aplikacionet e plotësuara dorëzohen në të njejtën zyre.

Me Kandidatët të cilët kanë konkuruar, do të mbahet intervista nga komisioni.

Për datën dhe kohën e mbajtjes së intervistës, kandidatët do të njoftohen me kohë.

Vërejtje: Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pa kompletuara nuk do të pranohen.

